

VENDIM
Nr. 133, datë 21.5.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “5GX ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË
INSTALUAR 10 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1570/1 prot., datë 19.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘5GX Energy’ sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw”,

konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “5GX Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 9.7.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 10 mw.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1570 prot., datë 12.5.2026, ajo ka paraqitur kërkesën për modifikimin e aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 10 mw.

- Nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 272, datë 4.5.2023 dhe kontratës nr. 2175 rep., nr. 484 kol., datë 23.6.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqëria është pajisur me të drejtën për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të Rregullores e po ashtu ka shlyer dhe pagesat e rregullimit.

2. Përputhshmëria e aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas germave (“c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”).

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, germa “a” të Rregullores, shoqëria duhet të depozitojë në ERE shtojcën 1 të plotësuar dhe, në lidhje me germën “b”, duhet të bëjë saktësimin përkatës të veprave ndihmëse dhe kapacitetit të secilës.

- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë, sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 9.7.2024, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti